

VENDIM
Nr.1055, datë 29.7.2009

PËR LICENCIMIN E SHKOLLËS SË LARTË PRIVATE “LOGOS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2,43,44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Licencimin e shkollës së lartë private “Logos”, e cila do të ushtrojë veprimtarinë në qytetin e Tiranës.

2. Shkolla e lartë private “Logos” do të organizohet në dy fakultete:

a) Fakultetin e shkencave të aplikuara, me programin e studimit të ciklit të parë “Informatikë e zbatuar”, në formën e studimeve, me kohë të plotë.

b) Fakultetin ekonomik, me programin e studimit të ciklit të parë “Menaxhim turizmi”, në formën e studimeve, me kohë të plotë.

3. Shkolla e lartë private “Logos” do të ofrojë programet e studimeve të ciklit të parë, me kohëzgjatje 3 (tri) vite akademike, me plotësimin, së paku, të 180 krediteve. Në përfundim të këtyre programeve të studimit lëshohet diplomë e niveli të parë (DNP), në:

a) “Informatikë e zbatuar”;

b) “Menaxhim turizmi”.

4. Ngarkohet shkolla e lartë private “Logos” që, për çdo program studimi, të sigurojë, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplinave kryesore formuese të specialitetit, pas vitit të parë, nga një personel akademik i huaj, me kualifikimin e nevojshëm.

5. Shkolla e lartë private “Logos” do ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se tri javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni privat i arsimit të lartë ka përmbushur angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin e tij, për këtë qëllim.

6. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe në elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

7. Shkolla e lartë private “Logos” duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

8. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha